

VENDIM
Nr.1136, datë 18.11.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I
RRUGËS SË TATIMEVE, NË BASHKINË E PEQINIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës së tatimeve, segmenti nga bulevardi “Mustafa Gjinishi”, deri tek unaza e qytetit, në bashkinë e Peqinit.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Peqinit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 105.2 (njëqind e pesë pikë dy) m², tokë truall, dhe 105.2 (njëqind e pesë pikë dy) m², objekt, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 2 461 469.6 (dy milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë pikë gjashtë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Peqinit, planifikuar në buxhetin e vitit 2009.

5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet po nga bashkia e Peqinit.

7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Peqinit, për realizimin e këtij projekti.

8. Regjistrimi i ri i pasurive, përkatësisht 105.2 (njëqind e pesë pikë dy)m², tokë truall, dhe 105.2 (njëqind e pesë pikë dy) m², objekt, shpronësuar në favor të bashkisë së Peqinit, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Peqinit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO
TË SHPRONËSOHEN PËR RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS SË TATIMEVE, NË
BASHKINË E PEQINIT

Nr.	Emër, mbiemër	Sip. truall m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera lekë	Dokum. i pronësisë	Zona kadast.
1	Familja Dervishi Agron, Anita, Zyra, Roland	105.2	2398	252269,6	Vërt. pron.	2908
	Shuma	105.2		252269.6		
	Emër, mbiemër	Sip. objekt m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera lekë	Dokum. i pronësisë	Zona kadast.
2	Familja Dervishi Agron, Anita, Zyra, Roland	105.2	21000	2209200	Vërt. pron.	2908
	Shuma	105.2		2209200		

	TOTALI			2461469,6		
--	--------	--	--	-----------	--	--